



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



---

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA  
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**Plani i Zbatimit**  
**për Ligjin e ri të Gjykatave**

Prishtinë, Nëntor 2011

## **PËRMBAJTJA**

- I. HYRJE**
  
- II. BURIMET NJERËZORE**
  - Pasqyrë**
  - Korniza kohore**
  
- III. BURIMET FIZIKE**
  - Pasqyrë**
  - Korniza kohore**
  
- IV. ADMINISTRATA GJYQËSORE**
  - Pasqyrë**
  - Korniza kohore**
  
- V. LOGJISTIKA**
  - Pasqyrë**
  - Korniza kohore**

## I. HYRJE

Pas miratimit të Ligjit të ri për Gjykatat (Ligji nr. 03/L-199) dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Ligji nr. 03/L-223), Kosova ka nisur një reformë rrënjësore të sistemit gjyqësor. Që nga 1 janari i vitit 2013, kur Ligji për Gjykatat (Ligji) do të bëhet plotësisht funksional, gjyqësori i Kosovës do të përballlet me ristrukturimin e plotë të sistemit gjyqësor.

Të gjitha gjykatat në Kosovë do t'i nënshtrohen transformimit të rrënjësishëm në bazë të strukturës dhe juridiksionit. Gjykatat e poshtëshënuara nuk do të funksionojnë më sipas këtyre emrave: gjykata e lartë për kundërvajtje, gjykatat e qarkut, gjykatat komunale dhe gjykatat për kundërvajtje. Të gjitha gjykatat e shkallës së parë do të quhen Gjykata Themelore dhe respektivisht Degë të Gjykatave Themelore. Gjykata e shkallës së dytë do të quhet Gjykata e Apelit.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), *ndër të tjera*, është ngarkuar me përgjegjësinë për përgatitjen dhe publikimin e Planit të Zbatimit (në tekstin e mëtejshëm 'Plani') gjer më 1 dhjetor 2011. KGJK është po ashtu i mandatar të ketë rolë prijës në zbatimin e këtij Plani.

Plani do të sigurojë veprimet e hollësishme si dhe kornizën kohore për tranzicion nga struktura e tanishme e gjykatave në strukturën e re. Në pajtim me nenin 37 të Ligjit, Plani është organizuar në katër shtylla kryesore: (1) burimet njerëzore (gjyqtarët dhe stafi administrativ i gjykatës); (2) burimet fizike dhe materiale; (3) administrata gjyqësore (lëndët dhe regjistrat), dhe (4) logjistika.

KGJK-ja do të themelojë një Komision *Ad Hoc* i cili do të ketë autorizime të plota sa i përket implementimit të këtij plani dhe aktiviteteve që duhet ndërmarrë. Ky Komision do t'i raportojë KGJK-së mbi ecurinë e implementimit të planit në baza periodike dhe sipas kërkesës së KGJK-së. Komisioni *Ad Hoc* do të përkrahet nga një ose më shumë grupe punuese, i përbërë nga gjyqtarët, stafi administrativ, duke përfshirë administratorë, zyrtarë ligjorë, bashkëpunëtorë profesionalë, të mbështetur dhe nga ekspertë të jashtëm që japin ndihmë teknike KGJK-së (USAID EROL dhe EULEX) në mënyrë që të përshpejtoj, monitorojë dhe mbështesë procesin e implementimit të këtij Plani.

Me qëllim të realizimit të suksesshëm të Ligjit të ri për Gjykata, KGJK mban të drejtën e zbrërthimit të mëtutjeshëm, plotësisht dhe ndryshimit eventual të këtij Plani.

## II. BURIMET NJERËZORE (GJYQTARËT DHE STAFI ADMINISTRATIV JO-GJYQËSOR)

### *Pasqyrë*

Transformimi i tërësishëm i sistemit gjyqësor në Kosovë, doemos kërkon që gjyqtarët dhe personeli jo-gjyqësor i gjykatave ti nënshtrohen sistemimit, transferimit dhe përshtatjes së pozitave të përcaktuara me Ligjin e ri.

Rrjedhimisht, personeli aktual i Gjykatës Supreme nuk do të pësojë ndryshime substanciale, përderisa personeli i Gjykatës së Apelit do të përzgjidhet me kujdes të veçantë në mesin e gjyqtarëve dhe personelit jo-gjyqësor që aktualisht veprojnë në Gjykatat e Qarkut, përjashtimit nga Gjykatat Komunale. Me qëllim të reflektimit të nevojave të ligjit të ri, kujdes të veçantë do të kushtohet përfaqësimit etnik për gjyqtarë, përfaqësisë gjinore si dhe kompetencave specifike që kërkohen në Departamentet e Specializuara të kësaj Gjykate (Departamenti për Krime të Rënda, Departamenti për çështje Administrative, Departamenti për çështje Ekonomike). Gjykata e Apelit duke qenë gjykatë e vetme e shkallës së dytë me juridiksion gjithë shtetëror, duhet të ketë afërsisht 35-45gjyqtarë. Rrjedhimisht, kjo do të kërkojë një staf të gjerë mbështetës administrativ.

Sa i përket burimeve njerëzore të Gjykatave Themelore dhe degëve të saj, aty ku është e nevojshme personeli administrativ do të bashkohet/shkrihet.

## **Gjyqtarët**

### *Parimet udhëzuese*

Që nga fillimi duhet të theksohet se Ligji i ri nuk përmban dispozita kalimtare mbi emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve. Në vend të saj, Neni 37.2.6. dhe Neni 38 i këtij ligji (Neni 38 është në fuqi që nga Janari i 2011) parasheh që gjatë fazës transitorë në strukturën e re të gjykatave, KGJK të *transferojë* dhe *ricaktojë* gjyqtarët në gjykata dhe pozita të përshtatshme si parashihet me këtë ligj.

Transferimi kërkon që gjyqtarët të lëvizin nga një gjykatë (e juridiksionit të një qyteti) në tjetrën, kur është e nevojshme. Në vend të kësaj, nëse gjyqtarët vazhdojnë të shërbejnë detyrat e tyre në gjykatat ekzistuese (pavarësisht nga fakti se gjykata mund të ndryshojë emrin apo juridiksionin e saj), kjo nuk nënkupton se i nënshtrohet *procesit të transferimit*.

Prandaj, në lidhje me nenin 38.1.3., vullneti i gjyqtarëve për transferimin e mundshëm do të kërkohej vetëm nëse aplikohet *procesit i transferimit*. Përgjithësisht, për nevoja të sigurimit funksional dhe efikas të gjykatave dhe për të adresuar rrethana të jashtëzakonshme, vullneti i gjyqtarëve nuk është i domosdoshëm gjatë procesit të transferimit (Neni 20.4 i Ligjit mbi KGJK-në).

Është për këtë arsye, që KGJK-ja do të ketë autoritet të plotë për transferimin e gjyqtarëve në përputhje me nenin 37 dhe 38 të këtij ligji si dhe nenin 20 të Ligjit mbi KGJK-në.

Ligji kërkon që KGJK gjatë *aktimit* të gjyqtarëve të merr parasysh dhe të respektojë procesin e emërimit (Neni 37, paragrafi 2.6, Ligji për Gjykatat). Ligji tutje përcakton se Këshilli duhet të merr parasysh dhe të respektojë "emërimet, në veçanti emërimet e Kryetarëve të Gjykatave, që bëhen gjatë procesit të emërimit siç parashkruhet nën paragrafin 1 të nenit 150 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës" (Neni 38 paragrafi 1.1). Prandaj përderisa të jetë e mundur, gjyqtarët do të caktohen në lokacionet e tyre të tashme gjeografike. Kjo preferencë megjithatë nuk pengon caktimin/transferimin e gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit, nëse KGJK-ja e konsideron këtë si të nevojshme.

Është politikë e KGJK-së që gjatë *aktimeve* për zbatimin e sistemit të ri të gjykatave të shfrytëzojë më së miri ekspertizën e gjyqtarëve të cilën e kanë fituar gjatë karrierës së tyre.

*Caktim i gjyqtarëve* do të jetë objektiv dhe do të bazohet në kritere që do të aprovohen nga KGJK-ja. Kriteret e veçanta, përfshirë kërkesat ekzistuese ligjore do të miratohen për Gjykatën e Apelit dhe departamentet e veçanta të Gjykatave Themelore. Përveç kësaj, kriteret për emërimin e Kryetarit të Gjykatës së Apelit, Kryetarëve të Gjykatave Themelore, Gjyqtarëve Mbikëqyrës së Degëve do të përfshijn arsimimin në menaxhment ose/dhe përvojën.

Caktimi dhe transferimi i gjyqtarëve do të jetë transparent dhe do të kryhet në kohë të mjaftueshme për të siguruar se sistemi i ri i gjykatave është funksional dhe operacional para 1 janarit 2013.

### Parimet udhëzuese gjatë procesit të caktimit dhe transferimit të gjyqtarëve

- Gjyqtarët e Gjykatës Supreme nuk do të preken gjatë fazës implementuese të Ligjit të ri të Gjykatave.
- Në parim, gjyqtarët nuk do të lëvizin nga gjykatat dhe lëndët të cilët aktualisht gjykojnë.

- Gjyqtarët e Gjykatave të Qarkut do iu ofrohet mundësia e shprehjes së interesit për të kaluar në Departamentet respektive të Gjykatës së Apelit.
- Nga kriteret e përcaktuara, KGJK në bazë meritore do të caktojë gjyqtarët në Departamentet respektive të Gjykatës së Apelit.
- Në rast se numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit nuk plotësohet nga interesimi i shprehur i gjyqtarëve aktual të qarkut, KGJK do tu ofrojë mundësinë e transferimit në Gjykatën e Apelit, të gjithë gjyqtarëve aktual të cilët plotësojnë kriteret ligjore.
- Gjyqtarët e Gjykatave të Qarkut të cilët do të mbesin në Gjykatat Themelore, do të vendosen fillimisht në departamentet e specializuara duke u bazuar në eksperiencë dhe përvojën e tyre (p.sh. Departamenti për Krime të Rënda, Departamenti Administrativ dhe Departamenti për çështje ekonomike).
- Për nevoja të vazhdimit dhe përfundimit të rasteve gjyqësore të cilat deri më datë 31 Dhjetor 2012 do të mbesin të papërfunduara dhe për shkaqe ligjore konsiderohen si të pa transferueshme, gjyqtarët dhe posaçërisht kryetarët e trupit gjykues do të vazhdojnë që edhe pas transferit të shërbejnë *ex officio* në panelet gjyqësore deri në përfundimin e rasteve të tilla të 'vazhdueshme'.

#### *Kriteret ligjore dhe kualifikimet për gjyqtar*

Kriteret profesionale ligjore që do të përdoren për caktim/transferim të gjykatës në Gjykatën e Apelit, do të jetë si kriter i emërimit që janë të parapara në Nenin 26 dhe 27 të Ligjit të ri të Gjykatave.

Sipas dispozitave të përmendura më lartë, kriteret e përzgjedhjes për caktim/transferim të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit, janë si vijon:

- Për të shërbyer si gjykatës në cilindo Divizion ose Departament të Gjykatës së Apelit, një gjykatës do të duhet të ketë dhjetë (10) vjet përvojë pune ligjore. Paragrafi 3 i Nenit 26 të këtij Ligji parashikon se përvoja në fushën ligjore përfshin përvojën si prokuror, gjykatës, avokat ose akademik.
- Për të shërbyer si gjykatës në *Departamentin e Krimeve Serioze*, gjyqtari duhet të ketë së paku tre (3) vjet përvojë si gjykatës për raste të krimit dhe të paktën gjashtë (6) vjet përvojë në fushën ligjore duke përfshirë përvojën në të Drejtën Penale. Përvojë si gjykatës në Gjykatën e Qarkut duke përfshirë edhe gjykimet për çështje penale.
- Për të shërbyer si gjykatës në *Departamentet për Çështje Administrative ose Ekonomike*, një gjykatës duhet të ketë të paktën gjashtë (6) vjet përvojë në fushën ligjore duke përfshirë përvojën në çështjet administrative ose ekonomike ligjore, përkatësisht.
- Për të shërbyer si gjykatës në cilindo *Divizion (penal, civil, për të mitur ose në përmbarrim) të Departamentit të Përgjithshëm ose Departamentit për të Mitur*, një gjykatës duhet të ketë të paktën gjashtë (6) vjet përvojë në fushën ligjore duke përfshirë përvojën në divizionin/departamentin përkatës në të cilin janë të interesuar të caktohen.

Gjyqtarit, gjatë shprehjes së interesimit për caktim në Gjykatën e Apelit, duhet të specifikojnë se për cilin Departament dhe Divizion të caktuar janë duke aplikuar. Në përputhje me këtë, gjyqtarit do të vlerësohen për *caktim* bazuar në kriteret e kërkuara nga ai Divizion/Departament përkatës.

Gjatë procesit të caktimit/transferimit të gjykatësve, KGJK-ja do të udhëhiqet nga tre parime në vijim: 1.) lloj-llojshmëria etnike e Republikës së Kosovës (Neni 17.3), 2.) parimet e barazisë gjinore 17.3) dhe 3.) përfshirjes gjeografike (Neni 17.1).

KGJK-ja më tej do të miratojë një rregullore të hollësishme për caktimin dhe transferimin e gjyqtarëve. Përveç kërkesave të lartpërmendura ligjore, rregulloret duhet të përmbajnë kritere shtesë, të cilat përfshijnë por nuk kufizohen në: përmbushja e normave të lëndëve që priten, trajnime profesionale dhe akademike si dhe kriteret që përmbajnë pikë negative që përfshijnë por nuk kufizohen vetëm me veprimet disiplinore ndaj një gjyqtari nga KGJK-ja, normave të pa përmbushura dhe kriteret e tjera objektive.

### **Sistemimi i personelit jo-gjyqësor**

Neni 37 paragrafi 2.3 i Ligjit mandaton KGJK-në që të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për planifikimin dhe sistemimin e stafit administrativ të gjykatave (personeli jo-gjyqësor). Përderisa vrojtimet e sipërpërmendura pasqyrojnë një transferim të rëndësishëm të gjyqtarëve, stafi i tanishëm administrativ i gjykatave do të vazhdojë të funksionojë brenda gjykatave ekzistuese duke pësuar përshtatje minore brenda pozitave ekuivalente.

Me shkrirjen e gjykatave të qarkut, gjykatave komunale dhe gjykatave për kundërvajtje në një gjykatë të vetme themelore, stafi administrativ do të shkrihet brenda kësaj gjykate. Kësisoj, do të paraqitet domosdoja e gjetjes së pozitave të përshtatshme për disa zyrtarë administrativë, pozitat e të cilëve do të pësojnë ndryshime.

Çdo Gjykatë Themelore do të ketë një Administrator dhe një Zëvendës Administrator. Përveç kësaj, KGJK-ja duhet të sigurojë që për secilën ndërtesë të gjykatës do të jetë së paku një Zëvendës Administrator. Administrata e degëve do të udhëhiqet nga një Zëvendës Administrator.

Në situatat kur administratori aktualë i gjykatës nuk do të bëhet administrator ose zëvendës në strukturën e gjykatave të reja, ata do të caktohen në pozitën e Shefit të Zyrës Qëndrore për Menaxhimin e të Dhënave apo Bashkëpunëtor Profesional, nëse plotësohen kriteret profesionale për ato pozita.

Administratorët e Rrjetit nga 1 janari 2013 do të emërohen si Zyrtarë të Teknologjisë Informative (TI) dhe do të ofrojnë asistencë për shërbimet e rrjetit dhe teknologjisë informative në gjykatën përkatëse.

Të gjitha pozitat tjera administrative, do të mund të pësojnë ndryshime minore në përputhshmëri me ligjin për shërbyesit civil dhe me qëllim të zbatimit të suksesshëm të Ligjit të ri për Gjykatat.

Në rast se stafi aktual i administratës e ka të pamundur të mbulojë nevojat e gjykatave përkatëse, Departamenti për Burime Njerëzore i KGJK, duhet të hap konkurs për pozitat e pa plotësuar. Lidhur me pozitën e re të Zyrtarit për Informim dhe Statistikë, KGJK do të tentojë të përshtat dhe bëjë lëvizjen e stafit aktual administrativ në këto pozitat e reja. Në rast se KGJK do ta ketë të pamundur të identifikojë persona të kualifikuar, do të duhet të shpallë konkurse për këto pozita të reja.

### **Afatet kohore për zbatim**

#### **15 janar 2012**

- Krijimi i një Grupi Punues të përbërë nga Gjyqtarët dhe një Grupi Punues të përbërë nga stafi administrativ i gjykatave për zbatimin e Ligjit të ri për Gjykatat.
- Rregullorja për caktimin dhe transferimin e gjyqtarëve në strukturën e re gjyqësore (duke përfshirë edhe emërimin e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës).
- Shpërndarja e Deklaratës për Transferimin e Gjyqtarëve në Gjykatën e Qarkut për caktimin e mundshme në Gjykatën e Apelit - 30 ditë për transferimin e deklaratave në KGJK.

- Shpërndarja e Deklaratës për Transferimin e Gjyqtarëve të Gjykatës Komunale për caktimin e mundshëm në Gjykatën e Apelit (nëse ka të tillë) - 30 ditë për transferimin e deklaratave në KGJK.

#### **20 janar 2012**

- Përcaktimi i strukturës përfundimtar të gjykatës dhe numrit të gjyqtarëve për gjykatë.

#### **20 janar-20 mars 2012**

- Vlerësimi i aplikacioneve dhe përzgjedhja e gjyqtarëve në Departamentin/Divizionin përkatës të Gjykatës së Apelit në mes të gjyqtarëve të interesuar dhe të kualifikuar të Gjykatave të Qarkut dhe Gjykatës Komunale (nëse ka të tillë).

#### **20 mars 2012**

- Fillimi i procedurës për përzgjedhjen e Kryetarit dhe zv. Kryetarit të Gjykatës së Apelit, 15 ditë pas pranimimit të aplikacionit.

#### **05 prill 2012**

- Përzgjedhja e Kryetarit dhe zv. Kryetarit të Gjykatës së Apelit në konsultim me gjyqtarët e Gjykatës së Apelit.

#### **05 prill – 05 maj 2012**

- Zgjedhja dhe caktimi i gjyqtarëve për të gjitha departamentet dhe divizionet e Gjykatave Themelore dhe Degët e saj.

#### **6 prill 2012**

- Fillimi i procedurës për zgjedhjen e Kryetarit dhe zv. Kryetarit të Gjykatave Themelore dhe Gjyqtarët Mbikëqyrës të Degëve të saj - *15 ditë për pranimin e aplikacioneve.*
- Fillimi i procedurës për zgjedhjen e Administratorit, Zëvendës Administratorit dhe personelin tjetër jo gjyqësor të Gjykatës së Apelit - *15 ditë për pranimin e aplikacioneve.*

#### **21 maj 2012**

- Zgjedhja e Kryetarit të Gjykatës Themelore dhe Gjyqtarit Mbikëqyrës të Degëve në konsultim me gjyqtarët e po atyre gjykatave.
- Zgjedhja e Administratorit, Zëvendës Administratorit dhe personelit tjetër jo gjyqësor të Gjykatës së Apelit në konsultim me Kryetarin e Gjykatës së Apelit.

#### **25 maj 2012**

- Fillimi i procedurës për zgjedhjen e Administratorit, Zëvendës Administratorit dhe personelin tjetër jo gjyqësor për Gjykatën Themelore dhe Degët e saj - **15** ditë për pranimin e aplikacioneve.

#### **30 korrik 2012**

- Përzgjedhja e Administratorit, Zëvendës Administratorit dhe personelit tjetër jo gjyqësor të Gjykatave Themelore dhe Degëve të tyre në konsultim me Kryetarin e Gjykatës dhe Gjyqtarin Mbikëqyrës të Degës përkatëse.

#### **10 gusht 2012**

- Publikimi i listës së gjyqtarëve (pozitat dhe lokacionet) dhe personelit jo-gjyqësor duke u bazuar në strukturën e re gjyqësore (faqja e këndit informativ të KGJK).

### III. BURIMET FIZIKE

#### Pasqyrë

Transformimi rrënjësor i strukturës së gjykatave së bashku me transferimin e personelit mund të kërkojë përshtatjen e resurseve fizike. Kjo gjithashtu përkrahet nga neni 37 paragrafi 2.4 i Ligjit i cili autorizon KGJK-në që të transferojë pasuritë fizike në mes të gjykatave, nëse kërkohet.

Nga pasuritë ekzistuese fizike, transferimi i mundshëm do të bëhet për artikujt zyrtar me të cilat janë ngarkuar *ad persona* - gjyqtarët dhe stafi administrativ. Kështu nëse një gjyqtar apo një shërbyes civil i administratës së gjykatës transferohet nga zyra ekzistuese e tij, administrata do aranzhoj transferimin e artikujve zyrtar (p.sh. kompjuterin, librat, etj.) në zyrën e re ku ai është caktuar.

#### Afati kohor për zbatim

##### 4 qershor 2012

- Zyra për logjistikë e sekretarisë së KGJK-së është përgjegjëse për të siguruar se çdo gjykatë ka orendi të mjaftueshme për zyrë, pajisje, kompjuterë dhe materiale tjera për të filluar punën sipas strukturës së re të gjykatave.

### IV. ADMINISTRATA GJYQËSORE

#### *Klasifikimi dhe transferimi i dosjeve të gjykatës*

Neni 37 paragrafi 2.1 kërkon ri-klasifikimin e lëndëve dhe numërtimin e lëndëve sipas strukturës së gjykatave të krijuar sipas ligjit të ri për gjykatat. Rregullorja për organizimin e brendshëm të gjykatave duhet të ofrojë listën e llojeve të lëndëve dhe formatin e numërimit të lëndëve për strukturën e re të gjykatave.

Në *Shtojcën 1 të këtij Plani Zbatues* është grafiku fillestar i llojeve ekzistuese të lëndëve dhe juridiksionin e tashëm të gjykatave dhe ku këto lëndë do të transferohen në gjykata sipas strukturës së re. Kjo shtojcë do të përpunohet dhe sqarohet më tepër gjatë fazës zbatuese.

#### Afatet kohore për zbatim

##### 5 nëntor 2012

- Gjykata Supreme, Gjykatat e Qarkut dhe Gjykata e Lartë për Kundërvajtje identifikojnë dhe inventarizojnë llojet e lëndëve të mbetura të cilat do të transferohen nëpër gjykatat përkatëse siç parashkruhet me Ligjin për Gjykatat. Lëndët të cilat me siguri se mund të zgjidhen para 31 dhjetorit të vitit 2012 duhet të mbahen dhe të zgjidhen nën juridiksionin e gjykatës aktuale.

##### 3 dhjetor 2012

- Të gjitha lëndët në pritje, përveç ato që mbahen për t'u zgjidhur, transferohen nëpër gjykatat përkatëse.

- Gjykata Themelore është përgjegjëse për shpërndarjen e lëndëve në Departamentin e përgjithshëm dhe Departamentin për të mitur në çdo degë të gjykatës brenda juridiksionit të vet.

### **3 janar 2013**

- Të gjitha lëndët e reja që parashtrohen në gjykatat aktuale nga 1 dhjetori 2012 deri më 31 dhjetor 2012 i transferohen Gjykatës së Apelit apo Gjykatave Themelore më 5 janar 2013.

## **V. LOGJISTIKA**

### **Pasqyrë**

Përkrahja logjistike ngërthen menaxhimin dhe administrimin e unifikuar të elementeve teknike logjistike që janë të domosdoshëm për planifikim, zhvillim dhe përkrahje për sistemin gjyqësor të Kosovës. Këto elemente mund të përfshijnë orendi për zyre, pajisje teknike, kopjues, material shpenzues për zyre, emblemat e gjykatës, regjistrat, kurset trajnuese për stafin e gjykatës etj.

Në përkrahje të KGJK-së për të ofruar mbështetje logjistike zbatimit të Ligjit për Gjykatë, Grupi punues i KGJK-së për këtë ligj, EULEX-i dhe USAID/EROL do të ofrojnë ndihmë për trajnimin e stafit të gjykatës në shfrytëzimin e regjistrave të ri të gjykatës dhe në metodologjinë e inventarizimit dhe transferimit të lëndëve nëpër gjykata sipas ligjit të ri për gjykatat.

### **Afatet kohore për zbatim**

#### **4 qershor 2012**

- Zyra për logjistikë e Sekretariatit të KGJK-së siguron prokurimin e emblemave të gjykatës për çdo ndërtesë të gjykatës në Kosovë në pajtim me Ligjin për Gjykatat.
- Komisioni *Ad Hoc*, pas të dhënave të siguruara nga Zyra për logjistikë e Sekretariatit të KGJK-së, përcakton sasinë e mbështjellësve të dosjeve, regjistrave, kutive dhe materialit tjetër për zyrë për të ndihmuar transferimin e lëndëve në mes të gjykatave për të zbatuar me efikasitet Ligjin për Gjykatat.

#### **9 korrik 2012**

- Zyra për logjistikë e Sekretariatit të KGJK-së, në bashkëpunim me Programin e USAID/EROL për gjykatat model, përcakton orenditë, pajisjet dhe materialin për zyrë që kërkohet për Gjykatën e Apelit dhe Gjykatat Themelore.

#### **1-10 Shtator, 2012**

- Grupi punues i KGJK-së, USAID/EROL dhe EULEX-i do të mbajnë një seri trajnimesh dhe seminare për kryetarët e gjykatave, administratorët e gjykatave dhe zyrtarët e gjykatave në përdorimin e regjistrave të ri të gjykatave.
- Grupi punues i KGJK-së, USAID/EROL dhe EULEX-i do të mbajnë një seri trajnimesh për kryetarët e gjykatave, administratorët e gjykatave dhe zyrtarët e gjykatave në metodologjinë efektive për përdorimin e inventarit të rasteve, regjistrave dhe për lëndët nëpër gjykatat përkatëse në pajtim me Ligjin e ri për Gjykatat.

- USAID/EROL do ti ofrojë asistencë Zyrës për Informim me Publikun (ZIP) të KGJK-së dhe ZIP të Gjykatave Themelore në zhvillimin e programit për kampanjë mediale dhe të komuniteteve me qëllim të informimit të qytetarëve për strukturën e re të gjykatave që do të zbatohet nga 1 Janari 2013.

#### **Tetor 8-19, 2012**

- USAID/EROL do të asistojë Zyrën për Marrëdhënie me Publikun të KGJK-së dhe Zyrtarët për Marrëdhënie me Publikun të Gjykatave Themelore në zhvillimin e programeve për media dhe komuniteteve për të informuar qytetarët për strukturën e re të gjykatave e cila do të zbatohet nga 1 Janari 2013.

#### **Shtator 2012 – Janar 2013**

- Kampanjë për informim dhe vetëdijesim të publikut për procesin e reformimit gjyqësor.

## Shtojca 1 - Transferimi i lëndëve sipas strukture së re të gjykatave

Origjina e lendes	Gjykata Supreme	Gjykata e Apelit					Gjykata Themelore					Verejtje / Komete
		Dep. I Pergj.	Dep Krime Serioze	D. M	D.Adm.	D.Eko.	Dep. I Pergj.	D. P.K.T.R	D. M	D.Adm.	D.Eko.	
AP		AP?	AP?									Per sqarim
AGJ	AGJ											
PN	PN?											Per sqarim
KP(kolegji penal)		KP										
APM				APM								
API			API?									Per sqarim
PKL	PKL											
PZD	PZD											
AC		AC										
REV	REV											
REV II	REV II											
KCRJ	KCRJ											
MLC	MLC											
PPC	PPC											
CN	CN?											Per sqarim
ADE						ADE						
AE						AE						
REV E	REV E											
MLE	MLE											
EN						EN						
A									A			
AA					AA							
KRjA	KRjA											
PPA	PPA											
MLA	MLA											
KMGJ	KMGJ											
REV.A.	REV.A.											
UGJS	UGJS											kalon ne sup.-regjister I ri

GJ. E Qarkut	Gjykata Supreme	Gjykata e Apelit					Gjykata Themelore					Verejtje / Komente
		Dep. I Pergj.	Dep Krime Serioze	D. M	D.Adm.	D.Eko.	Dep. I Pergj.	D. P.K.T.R	D. M	D.Adm.	D.Eko.	
PPr							PPr					
PPM									PPM			
P							P					
PM									PM			
PN							PN					
KP							KP					
KA							KA					
CN							CN					
C							C					
APM				APM								
AP		AP?	AP?									Per sqarim
AC		AC										
NDI							NDI					
AGJ							AGJ					
								UGJ				Regjister I ri

GJ. Komunale	Gjykata Supreme	Gjykata e Apelit					Gjykata Themelore					Verejtje / Komete
		Dep. I Pergj.	Dep Krime Serioze	D. M	D.Ad m.	D.Eko.	Dep. I Pergj.	D. P.K.T.R	D. M	D.Adm.	D.Eko.	
ED							ED					
PPr							PPr					
GJK							GJK					
RNGJ							RNGJ					Per sqarim
VR							VR					
AGJ							AGJ					
Apostil							Apostil					
E							E					
N							N					
T							T					
NDI							NDI					
KA							KA					
KP							KP					
P							P					
C							C					
PPM									PPM			
PM									PM			
PnH							PnH					

GJ. Ekonomike	Gjykata Supreme	Gjykata e Apelit					Gjykata Themelore					Verejtje / Komete
		Dep. I Pergj.	Dep Krime Serioze	D. M	Dep. Adm.	D.Eko.	Dep. I Pergj.	D. P.K.T.R	D. M	Dep Adm.	D.Eko.	
AGJ							AGJ					
CE												CE
E.Eko.							E.Eko.					
L(likuidim)												L(likuidim)
GJ. E Larte Per Kundervajtje	Gjykata Supreme	Gjykata e Apelit					Gjykata Themelore					Verejtje / Komete
		Dep. I Pergj.	Dep Krime Serioze	D. M	D.Ad m.	D.Eko.	Dep. I Pergj.	D. P.K.T.R	D. M	D.Adm.	D.Eko.	
AGJ		AGJ										
AK-REGJ. II		AK-REGJ, II										
AK-REGJ. III		AK-REGJ. III										Rishqyrtimi I vendimit(MJ)

GJ. Per Kundervajtje	Gjykata Supreme	Gjykata e Apelit					Gjykata Themelore					Verejtje / Komete
		Dep. I Pergj.	Dep Krime Serioze	D. M	D.Adm.	D.Eko.	Dep. I Pergj.	D. P.K.T.R	D. M	D.Adm.	D.Eko.	
AGJ							AGJ					
RK							RK					
RE							RE					
PPK							PPK					Perseritja e procedures kundervajtjes(MJ)

